A. ZAKO - ÇAJUP.

PAS VDEKJES

Komedie

BKSH

Kairo 1910. Potim'i Parë.

BKSH

PAS VDEKJES

PREJ

A. ZAKO-ÇAJUP

BOTIM'I PARË

BKSH

Vënë në Shtyp
prej
SOFOKLI ÇAPI.

E drejta e botimit

rezervohet.

BKSH

VETA.

Zonjëza LULUSHE - mësonjëse për vajza

Zoti ADHAMUDHI - shëronjës shkronjëtar

Zoti VURKO - gazetë-shkronjës, e korespondnte i Gazetës "Rufea"

ZENELI - Sherbëtor ndë një Klub, ndënë kryesi të Skendo Beut, drejtor'i "Lirisë"

◎◎◎◎

Nd'Odë të Klubit

me Gusht 1910.

BKSH

BKSH

PAS VDEKJES

I

Pun'e vetëme

Zeneli - Adhamudhi

(Ryjnë bashkë nd odë të klubit ku gjënden plot karreklla, një tryezë ndë mes ngarkuar me gazeta, me dorë-shkrime, më të djathtë një dollap, më të mëngjër një telefon ndë mur.)

ADHAMUDHI — (me zëmërim) Çudë s'mund të marr vesh ! . . yt zot, Kryetar i klubit, më dha fjälë të piqemi këtu më 8 pas dreke, dhe ti më thua që s'ëhtë këtu ! i the bre se kush jam unë ? a i tregove që jam unë, doktor Adhamudhi që po rri e pres ?.

ZENELI — (duke qeshur ndënë buzë) Doktor efendi, nuk'i thashë gjësend beut se s'është këtu !

ADHAMUDHI — Dreqi të martë ! . .

ZENELI — Qysh ? më ndje, zotëni. se . . .

ADHAMUDHI — M'a paske gjuhënë bilbil !

ZENELI — (me vetëhe) Qënka i çmëndur !

BKSH

II

ADHAMUDHI, VURKUA, ZENELI

VURKUA — (duke rytur me rëmbim) Zenel, a erdhi Skëndo Beu ?

ZENELI — Jo ! zoti Vurko, po s'besoj të mënojë. Prit pakëz në mos ke punë. Urdhro e rri,

VURKUA — (duke ndënjur) Dot'a pres.

ADHAMUDHI — (madhështor) Dotë pres dhe pakëz si do që kam punë shumë !

VURKUA — (ndë vesh të Zenelit) Kush është ky ?

ZENELI — (duke folur fort) Si ! s'e njofke, a ? zotënia është doktor A-dha-mu-dhi ! nga Frashri.

VURKUA — (duke qeshur fort) Lot a qesh, bre Zenel ? ç'farë èmër ky ?

ADHAMUDHI — (i vrejtur) Duket s'të pëlqen ?

VURKUA — (me butësi) Jo ! zotëni, fort' i bukur Adham (ati ynë i parë), Udis emër'i dytë i Odisit, si thot' Omiri).

ZENELI — (i habitur) Ah ! . . . se ç'do me thënë të jesh i di-tun ! un i gjori e pandej shqip . . dhe duk'me ditur se Doktori

është i Krishtërë, mëndoneshë ç'ditë luset shëjnt Adhamudhi, që të vejë t'a urojë !

ADHAMUDHI — (i rëndë) Si do q'është ky ëmër (vështron Vurkon) un'e kam nderuar !

ZENELI — (duke kqyrë Vurkon) Vërtet ! vërtet ! zotnia është shëronjës i dëgjuar ! .

ADHAMUDHI — Dhe shkronjëtor, vjershëotr !

VURKUA — (duke unjur) T'u ngjatë jeta. Doktor Adhamudhi ! Gëzonem fort që njojta sot zotërinë t'ënde ! Nder i math, për Zonë ! unë jam, korespondent i Gazetës "Rufea"

ADHAMUDHI — Ah ! qënkej zurnalist ! . . .

VURKUA — Ndaj të lutem, Doktor efendi, të m'apësh një "interview" t'a dërgoj te "Rufeja".

ADHAMUDHI — Mos thuaj Rrufeja, po thuaj; Rrufea ! rrufe, rrufea; liri, liria. dhe jo lirija ! Dot'i them dhe Skëndo Beut ! Kjo gjuhë që përdorni ju sot s'është shqip ! . . Kjo punë ka rënur në duar të liga : kurrë s'ka për të vajtur mbarë ! . . Abetari që përdorni ju s'është për të qënë ! . . .

VURKUA — (i-ndruar) Qush ? po e ka vëndosur Kongres i Manastirit ! . . .

ADHAMUDHI — (me rrëmbim) Kongres'i Manastirit ! ç'është Kongres'i Manastirit ? Kush vate ? a vajta unë ?

VURKUA — (duke qeshur) Pse s'vajte, or zot ?

ADHAMUDHI — Ah ! ah ! përpara më thoshe Doktor efendi ! tani qënkam vetëm zot ! se fola të vërtetën ! thashë ato që janë ! Dhe guxhon të më kërkosh " interview " ! Jo ! jo ! s'kam zakon unë, të jap interview, jo ! . . . për gazetat t'uaj ! . . .

VURKUA — s'pandeje kurrë, s'të dije për armik të gazetavet !.

ADHAMUDHI — (i rendë): Ja ku e mësove tani ! dhe t'ja thuash gjithë potës me anë të "Rrufesë", në ka njerës t'a këndojnë ! . . . Këto janë fjalët e fundit ! .

VURKUA — Janë mjaft për tu çuditur.

ADHAMUDHI — (me zëmërim) Pse për t'u çuditur? fundi, fundi, s'më dërsin veshi për botë, mua ! Drëq o punë ! . . ndëjo: ç'fitm dotë kem unë, kur të shkruash ti për mua: "Doktor Adhamudhi, shëronjes'i shkëlqyerë, që ka botuar kaqë vepra të bukura, që ka gjetur një bar të ri për ethë, një tjetër bar më të çudihsim. më të nevojshëm, per gratë shterpa, ka sot gati për të botuar një abetar fort të mbaruar për Shqipen, me shkronja të ra. me sistem të ri. dhe për ket'abeiare është munduar 10 vjet plot dhe tri muaj ? " Gazetat, mua, s'më ryjnë në punë ! Levdata nukë dua nga kur kush ! Po të kerkoje të tilla gjera, mor zot, dotë të marrë me të mirë dhe dotë rrëfejë se për ç'punë kam ardhë sot të Skëndo Beu. . . t'i tregoj vetëm këtë

abetare dhe të mësoj a mund të jet'i pëlqyer te Xhon Turqit : a u vjen mbarë që të përhapet dhe të përdoret ndë shkolla të Shqipërisë; a duan të m'a blejnë; a munt të shpresoj nga Qeveria nonjë punë të mirë për këtë shërbim të math! Skëndo Beu më tha t'ja sjelle sot ndë Klub t'a kqyrin bashkë me zonjëzën Lulushe q'është mësonjëse për çupa dhe po të jetë që t'a gjëjë kjo për mbarë, dot' vejë përpara ndë shkollë të çupave, dhe m'u dorëzua për Xhon Turpit se dotë kënaqen tepër dhe diç do të bëjnë për mua : mund që të më dërgojnë Deputet në Stamboll ! . . .

VURKUA — Po ky abetar pse do të viret vetëm ndë shkollë të çupavet ?

ZENELI — (me rrëmbim) : Vërtet pse ?

ADHAMUDHI — (fodul): Po s'e kuptoni ?

VURKUA — Për syt e ballit, jo ! . .

ZENELI — (me gas) Un'ë gjeta ! çupat janë fëmra . . . u pjell mëndja ! . .

ADHAMUDHI — Ç'del nga kjo gjëh ?

ZENELI — Qysh ? . . janë më të zgjuara se djemtë qhe do të nxënë më mirë abetarin. S'është vërtet kjo fjalë ? . . .

VURKUA — Si dy e dy bëjnë katër

ADHAMUDHI — U kripsha trutë! Shkaku i vërtetë është ky: Çupat bënen gra!.. dhe burrat bejnë si thonë gratë!... Për këtë gjë kam shkruarë një libër të gjër e të gjatë.

VURKUA — Ahere pun'ë abetarit është ndë dorë të Zonjëzës Lulushe?

ADHAMUDHI — Edhe ndë dorë të Skëndo Beut, se ky e ka fare mirë me xhon Turqit: i ka miq.

VURKUA — (i habitur) I ka miq!...

ADHAMUDHI — Prandaj, si të thashë, as pyes fare për njerës të tjerë dhe për gazetat t'uaj!...

VURKUA — As për "Bashkimin e Kombit?

ADHAMUDHI — Jo!

VURKUA — As për Rrufenë?

ADHAMUDHI — As pak!... Mor zot, pse bën dëm fjalët? s'krren dot fjalë nga unë... S'pres nder nga njeri kurrë!.. Lëvdata s'dua!... Si do që të thonë, shëronjës si unë janë të rallë: shëroj sy, veshë, hundë, duar, këmbë! Ç'do sëmundje dridhet nga unë! Dotë thuash që s'kam shumë "myshtërinj" Kurrë mos arçin! Le të vuajnë! Kush u ka faj?

VURKUA — Po abetarin pse kërkon t'a sheç të xhon Turqit? pse s'ja fal ShqiPërisë?

BKSH

ADHAMUDHI — Ah ! t'a fal ! . . . Të vras mëndjen ! të punoj dhjet vjet natë e ditë... dhe pastaj t'a fal dhe kujt ? Shqipëtarëvet! . . . dhe të mos m'a dinë Sa vjet punojnë Shqipëtarët për gjuhën ! dhe s'gjejnë dot nj'abetar për të qënë ! un'e gjeta ! ja tek e kam, ndë xhep ! Zonjëza Lulushe në ka dy koqe mënt, dotë çuditet kur t'a këndojë ! . . . dotë lërë mëntë !

VURKUA — S'ka dyshim ! Dotë vijë dhe ajo sot këtu ?

ADHAMUDHI — Posi, po ! Beu më dha fjalën.

VURKUA — A e një zonjëzen Lulushe ?

ADHAMUDHI — Po si S'e njo ? Tërvit kish t'ëmën me ethe. Për këtë sëmundje kam gjetur, si të thashë, një bar të ri, Kush është për të shëruar, shëronet në mos po vdes ndë gjumë pa kuptuarë, pa munduar fare. Kështu pra, kur e piu e ëm'e Lulushes...

VURKUA DHE ZENELI — (bashkë) U shërua !

ADHAMUDHI — Vdiq ndë gjumë e sipër si çkeshë thënë.

ZENELI — Bar'i mirë : një me një...

ADHAMUDHI — (te Vurkua) Këto janë, zotënj, veprat e mija ! Lëvdata s'dua ! fjalët i mer era ! . . . Punë, punë ! ç'del nga gazetat ? kurrë gjë.. Pandaj mos u mundo kot, mos hump kohën: nuku krren dot as një fjalë nga mua !

BKSH

VURKUA — (dukë qeshur) Mjaft janë këto që më the!... T'u ngjatë jeta! Lamtumirë, doktor efendi! (del jashtë)

ADHAMUDHI — (me inat) Ah! i malkuar! Më bëre të flas shumë! pa dashur të dhashë "interview"! po të mos më dalç përpara tjetër herë!...

III

ADHAMUDHI — ZENELI

ADHAMUDHI — (shikon orën) Çudi! 8 1/2 dhe skëndo Beu s'duket të vijë! Bre Zenel! po as zonjëza Lulushe s'erdhi?

ZENELI — Jo, zot, jo! s'pashë as një grua të na vijë sot këtu!...

ADHAMUDHI — (me zmërin) Ç'do më thënë! mos qeshin më mua!... Dreq o punë! (rri pranë tryezës dhe mer e kqyr do-rëshkrimet që gjënden mbi tryeze; pas pak, ngrihet me vrap, i habitur, duke thënë me rrëmbim) Vdiq Hazhi Aliu! Dreq o punë! Mos më bëjnë sytë!... Po jo! paska vdekur pa prit, pa pandyer! Un'e lashë mirë!... pak i dobët, po jo për vdekje! i gjori hazhi Ali! i mjeri Ali Hozhi! I gjori Deputët e keshë mik! Dhe kërkonte të më vinte ndë bukë të Qeverisë! Fat ziu Hazhi Ali! Ali Hazhi! Paska vdekur!...

BKSH

ZENELI — Jo, zot, jo ! s'ka dhe vdekur ! po mbase heq shpirtin ! . . .

ADHAMUDHI — S'ka dhe vdekur ! . . . po ahere ç'thoni ketu? (këndon dorëshkrimin) "Me hidherim të math mësuam seDeputeti i çkelqyerë Haxhi Aliu dha shpirtin . . ." (te Zeneli) Dreq o punë ! Ju i vdisni njerstë me të pahir ¡

ZENELI — T'u ngjatë jeta, duhet të dish se një gazetë me rëndësi si "Liria" duhet të ketë gati shkrime për ç'do punë, për ç'do gjëmë që munt të ngjajë një ditë, që të mos ndodhet gafil . për shëmbëll : këtë natë, ndë mes të natës, mund të na vijë një tel të na msojë se Haxhi Aliu hëngri buk'e fiq e vdiq ! Drejtor' i "Lirisë" s'ka kohë, ahere, të msojë se kur lindi Haxhi Aliu, nga kush lindi, ç'ka bërë dhe ç'nukë ka bërë ndë jetë të tij. Për këtë shkak bën gati shkrimet . . . dhe kështu Haxhi Aliu munt të vdesë kur të dojë ! se gazeta jonë dotë shkruajë për të gjërë e gjatë q'atë çast .

ADHAMUDHI — (kqyr dorëshkrimin) He ! he ! pa dyshim Haxhi Aliu do të kënaqej fort sikur të këndote këtë shkrim plot më levdata ! . . . Pra më thuaj, bre Zenel, sa dit janë q'u shkrua ky artikull ?

ZENELI — Janë mjaft ditë, zotëni, se drejtor' i "Lirise" di ç'punon kur do herë : Për gjithë njërzit e shkëlqyerë kemi gati shkrime të vdekjes ! kemi për mbretrit, se jet'e tyre varet

shumë herë nga një filxhan me kafe, nga një thikë, nga një revol ! . . . Kemi shkrime gati dhe për deputetë, se më të shumët janë pleq... Kemi për shkronjetarë të ndëgjuarë, për njerës të mëdhenj...

ADHAMUDHI — Për njerës të mëdhenj ?

ZENELI — Po si po ! për shëmbëll, një shëronjës i math mund që të bëjë këmbët bigë si ç'do njeri tjatër . . .

ADHAMUDHI — Ashtu bir, ashtu vërtet. (si'mëndonet pak) Nukë më thuaj, paç uratën, më ke a s'më ke për të math mua, Adhamudhin ?

ZENELI — Më pyet në je plak ?

ADHAMUDHI — Jo, bre bir ! të pyes a më ke mua, për të math ?

ZENELI — Në je i gjatë fort ?

ADHAMUDHI — (me butësi) Jo, bre Zenel ! dua të më thuash në jam dhe unë një njeri i math, do me thënë, në jam i ndëgjuar si shëronjës, si shkronjtar me mënt !...

ZENELI — Ashtu thuaj, de !..

ADHAMUDHI — Folë pa ndrim; unë. doktor Adhamudhi, jam a s'jam njer'i math ?

BKSH

ZENELI — (me ndrim) në je!...

ADHAMUDHI — Ngeri i math!

ZENELI — Besa! s'do pyetur!.. je i math!

ADHAMUDHI — (i kënequr) Mos qesh me mua!

ZENELI — Jo, bër Zonë, s'kam dyshim që je njeri i math!...

ADHAMUDHI — Nga më kupëtove ?

ZENELI — Se nukë je i vogël!?..

ADHAMUDHI — Tjetër shkak?...

ZENELI — Se Kam degjuarë shumë njerës të bëjnë fjalë për zotnin t'ënde!

ADHAMUDHI — Tjetër shkak?...

ZENELI — Se s'ke qime ndë krye! m'a ke si kungull... je koke shinik!... ndaj them se do të jesh a qose'a i mëndshur.

ADHAMUDHI — (i kënaqur) Dike dhe ti të tilla ?

ZENELI — M'i ka mësuar gjyshja, ndjesë pastë!

ADHAMUDHI — Ndjesë pastë! paska qënë e mëntshur... Ahere beu yt, Skëndo Beu, dotë këtë bërë gati dhe për mua një sqkrim të... vdekjes? Folë, bre Zenel, më qafsh!

BKSH

ZENELI — Z'do pyetur ! s'ka dyshim ! se vërtet s'je deputet, po s'je sot trim i ri,je burr'i thyer . . . fjala mos na daltë e martë dhenë . . .

ADHAMUDHI — Mirë ? mirë ! po, bre Zenel, a mund të të vë besë ?

ZENELI — për ç,punë ?

ADHAMUDHI — A mund të mbash fjalë të mshehur

ZENELI — Sa për këtë gjë, mos ki frikë, jam si peshku . . . s'më kërren dot fjalë as me darë ! shpyrti më del po fjala s'del nga goja ime ! (me vetëhe) ndë kish'e ndë mulli . . .

ADHAMUDHI — Fort mirë ! më kënaqe . . . na, merr këtë . . (i ve ndë dorë një mexhite)

ZENELI — (i habitur) Një mexhite ! për mua ? . . .

ADHAMUDHI — Për ty ! . . .

ZENELI — Si do që jam Musulyman me vjen të bej kryq me dy duar ! . . .

ADHAMUDHI — Pse ?

ZENELI — Kam dëgjuar që je fort dorë shtrënguar . .

ADHAMUDHI — Mos bëso botën .

BKSH

BIBLIOTEKA KOMBËTARE TIRANË

ZENELI — Një mexhite ! bër mua !

ADHAMUDHI — Kam dhe dy të tjera për ty sikur të më tregosh . . .

ZENELI — Dreq o punë ! e mora vesh për zonë ! do të shoç ç'ka shkruar im zot për ty . . . shkrimin që dot botojë "Liria" kur të na lësh shëndenë ! . . .

ADHAMUDHI — Të lumtë ! a m'a rrëfen ?

ZENELI Dreq o punë ! Pse jo ! po s'mba mënd mirë se ku gjëndet .

ADHAMUDHI — kërko, më rrofsh !

ZENELI — Po duet te m'a kthesh prapë që t'a vë ndë vënt .

ADHAMUDHI — S'ka dyshim !

ZENELI — Fort mirë, Kur t'a gjëj një ditë . . .

ADHAMUDHI — Ç'një ditë ? e dua tani !

ZENELI — Tani . . . (kërcet telefoni dhe Zeneli vete me vrap dhe pyet me telefon) allo ! . . .
Unë Zeneli ! . . . Kush ? . . . Po, po, është këtu Doktor Adhamudhi, po zonjëza Lulushe s'ka dhe ardhë ! . . . (te Adhamudhi) ësht'im zot, Skëndo Beu .

BKSH

ADHAMUDH — Ah ! . . lemë të flas vetë (vete nde telefon) Allo ! . . . jam unë, Adhamudhi . . . Fort mirë, zotrote si je ? . . . Po, po, kur më the i vajta ndë shtepi . . . Po, i dhëmb një sy . . . do kryerë shpejt që të mos i dhëmbë dhe tjetri ! . . . I thashë po nukë do ! . . . T'i vete prapë ? fort mirë !. . . kush dotë më paguajë ? Ah ! zotrote, fort mirë ! . . . Kur ? që këtçast vete të ja kërrej ! . . . Ashtu po, pas dy orë dotë kthenem këtu të flasëm për abetarin shqip ! . . . Dotë shoç, dotë shoç se ç'është ! Po, të të gjëj vërtet ndë Klub ! . . . Posi, po : dhe zonjëza Lulushe duhet të jetë këtu . . . Të paça shumë . . . Qofsh me shëndet !

ZENELI — Kuijt i dhëmb syri, doktor efendi ?

ADHAMUDHI — S'e paske mësuar ? Mehdiut...

ZENELI — Mytesarifit ?

ADHAMUDHI — Po ! Skëndo beu më lutet t'a shëroj .

ZENELI — Dhe zotnia jote kërkon t'i kërresh synë !.

ADHAMUDH — S'bënet ndryshe ! un' e kam gjetur këtë metodhë të re; të dhemb një dorë ? preje që të shpëtojë tjatra të dhëmb një këmbë ? preje që të shpëtosh tjatrën ! Të dhëmb një sy ? kërreje, që të mos sëmuret dhe tjetri ! . . Kështu bëra dhe për t'ime shoqe : i thëmbi një dit syr'i djathtë; me vrap ja

krreva ! dhe sot syr'i mëngjër është shëndosh'e mirë, sa shëkon dhe natën ! . . .

ZENELI — Dreq o punë ! shëroke fort bukur ! Ahere, zotëni, kuijt i dhëmb koka i dashka prerë ! . . .

ADHAMUDHI — Pusho, bre Zenel; Këto gjëra janë të larta, të thella; ti, s'i kupëton dot . . . unë kam ngrënë jetën time ... Po mos harro, të lutem, fjalën që më dhe për shkrimin .

ZENELI — As zotrote mos haro të dy mexhitet .

ADHAMUDHI — Peshin; bre burrë ! Po kërko t'a gjësh sa të vete të Mehdiu dhe të kthenem. Ah ! po të vijë zonjëza Lulushe këtu thuaj të më presë .

ZENELI — Fort mirë, doktor efendi ! udh'e mbarë ! . . . (Adhamudhi del jashte) .

IV

ZENELI — (vetëm) Dy dhe një që kam bëjnë tri mexhite, për Zonë ! Si duket kjo ditë dotë më vejë mbarë : (del të dera dhe thërret) : zoti Vurko ! zoti Vurko ! të lutem eja pak mbrënda se kam dy fjalë të të them . . . (ryn mbrënda Vurkua)

V

ZENELI, VURKUA

VURKUA — Ç'më do, bre zeneli ?

ZENELI — Të lutem të më bësh një sherbim.

VURKUA — Dy, tri . . po të më dalë nga dora. Folë.

ZENELI — Dua të më shkrnash një artikul për një të vdekor të math. . .

VURKUA — Pse ? Vdiq no një njeri i math ? Thaujmë kush vdiq se munt t'i këm gati shkrimnë.

ZENELI — S'ka dhe vdekur. . .

VURKUA — Ahere ç'kërkon ? prit të vdesë, pre burrë.

ZENELI — Unë pres, po ay q'e do s'pret. . . Kërkon t'a shojë pra të vdesë ! . . .

VURKUA — Kush është ? të lutem.

ZENELI — Dhashë fjalën të mos ta trëgoj.

VURKUA — Nga unë ndruan, bre vëlla ?

BKSH

BIBLIOTEKA KOMBËTARE TIRANË

ZENELI — Vërtet! ndë mes t'ënë... Ndëgjo: doktor Adhamudhi do të dijë se ç,do të thonë për të kur të vdesë;

VURKUA — Ah! dhe guxon të thotë që s'i do gazetat, s'kërkon lëvdata, miku!.. Zenel, a do të paguajë gjë Adhamudhi ?

ZENELI — Ç'do të thuash ?...

VURKUA — Po kjo s'është puna ime... Tani vete të shkruaj artikullin që kërkon.

ZENELI — Ah! më rrofsh! sta shpërblej dot kurrë ...

VURKUA — Le, mor vëlla këto fjalë .. ndë mes t'ënë! ..

ZENELI — Ndëgjo, të lutem..

VURKUA — Ç'do prapë ?

ZENELI — Si Kur t'a shojë të shtypur dot'i pëlqejë më tepër mikut; ndaj ...

VURKUA — Fort mirë! e dërgoj me vrap ndë shtypë. shkronjë të kristos dhe ...

ZENELI — Oh! të paça shumë më rrofsh! ....

VURKUA — Mirë; mirë, lamtumirë! (del jashtë).

BKSH

VI

ZENELI, PASTAJ ZONJEZA LULUSHE

ZENELI — (vëtëm) Adhamudhi dotë kënaqet fort : Këta njerës kur shonë gjësend të shtypur ndër kartë, e bëjnë të vërtetë si ungjill, si koran ! . . . i marroftë Zoti ! (Zonjëza Lulushe ryn duke thënë mirë-dita) !

ZENELI — Qofsh zonj'e madhe ! . . . im zot s'ka dhe ardhur po rri t'a prëç pakëz, mund të vijë . Dhe që të mos merzi tesh duke pritur, urdhëro e ri pranë tryezës dhe këndo këto shkrime, sa të ndërtoj pak odën .

ZONJA LULUSHE — (duke parë shkrimet, gjeti artikulin e Haxhi Aliut dhe briti) Haxhi Aliu paska vdekur ¡ fat-ziu Deputët! sa rëndë më erdhi ! ...

ZENELI — Mos të vijë kaqë rëndë, zonjëzë, se kemi shpresë ?

ZONJA LULUSHE — Shpresë ! Shëronjësit mos dot'a ngjallin përsëri ?

ZENELI — Ah ! në priçim nga shëronjësit ! . . .

ZONJA LULUSHE — Po ahere ç'shpresë ! ....

ZENELI — Haxhi Aliu s'ka dhe vdëkur !

ZONJA LULUSHE — Zoti e shpëtoftë ! burr'i mirë si kam dëgjuar të thonë ! Po kur s'paska vdekur, pse kini bërë këtë shkrim vdekje ?

ZENELI — Se është ndë buzë të varrit dhe ja bëm gati që të mos ndodhemi gafil kur të vdesë. . . .

ZONJA LULUSHE — Po n'u shëroftë ?

ZENELI — Ahere shkrimi vloet ndë zyrë bashkë me shumë të tjerë, dhe botonet kur t'i-vijë sëra ! Duet të dish, moj zonjëzë, se ghithë njerstë me rëndësi, burra a gra qofshin, kanë këtu gati shkrime për ditën e vdekjes .... si mbretret, mhretëreshat, depytenjtë.... se nukë diet kur e-përdredhin.... bishtin !

ZONJA LULUSHE — (me zëmërim) ; I-bukur zakon ky ! U-hiqni të mbarën !..

ZENELI — S'u-bëjmë të ligë... i-lëmë të vdesën kur të duan ! neve kemi dëtyrë të bënemi gati që të mundim t'i-lëvdojmë !

ZONJA LULUSHE — Thuaj si të duash : nukë dotë më vinte mirë farë, unë ghall e me të gjallë, të kem gati shkrimn'e-vdekjes !

ZENELI — Oh ! për një grua si zotënin t'ënde, mos pande se im zot s'ka bërë gati gjë-send...

ZONJA LULUSHE — Ka shkruar dhe për mua !...

BKSH

ZENELI — S'ka dyshim, se nukë je e-pakët !....

ZONJA LULUSHE — (me vetëhe): ç'mund të ketë shkruar për mua? më ka lëvduar? më ka sharë? ç'mund të thonë për mua kur të mos jem ndë jetë? (te Zeneli): Beson ti se kanë shkruar dhe artikullin t'im që tani?

ZENELI — Në besoj, thotë !... e-di fort mirë! si bukën që ha..

ZONJA LULUSHE — Ndëgjo !

ZENELI — (me gas): Folë, zonjëzë, ç'urdhëron?

ZONJA LULUSHE — A mund të m'a-tregosh?

ZENELI — (shtiret si-Kur s'kupëton): ç'të të tregoj?

ZONJA LULUSHE — Shkrimin e ....vdekjes !...

ZENELI — (tund kokën): Punë që s'bënet.

ZONJA LULUSHE — Pse?

ZENELI — Se dotë ndëgjoj fjalë të tharta!

ZONJA LULUSHE — Të lutem, Zenel, për mua ....

ZENELI — Kërkomë gjësend tjetër, po këtë jo ! Kurrë ! im zot dotë më kërreje nga Buka... jo. jo !

ZONJA LULUHSE — Nga kush dot'a-msojë? vetëm t'a-këndoj

BKSH

dhe pastaj vëre prapë ndë vënd për këtë mundim ke 5 mexhite.

ZENELI — Pesë mexhite ! ndëron fjala ! punë që bënet, pasha zonë !

ZONJA LULUSHE — Të lumtë ! rrofsh sa malet. Tani vete me vrap të ndjek qerren që më pret jashtë dhe ti kërko, kërko . . . mos humb kohën (del).

VII

ZENELI — VETEM

ZENELI — një dhe dy, bëjnë tri, dhe pesë që dotë mar bëjnë etë ! tetë, mexhite ndë një ditë ! puna sot vete mbarë ! si s'e-mendova këtë punë më parë! Qënkam budallë bre!.. qënkam i lënur ! këtu qënka punë ! Po s'është von.... dale pa më she!.. (Hap derën dhe thëret) : Zoti Vurko ! he ! Zoti Vurko ! të lutem dy fjalë vetëm !

VIII

ZENELI, VURKUA

VURKUA — (ryn me një shkrim ndë dorë) na, e-mbarova artikullin e doktorit. Ç'kërkon prapë nga unë! folë se s'kam nge !.

BKSH

ZENELI — Më ndjë. zoti Vurko ! ..... qysh të të them.... s't'a them dot.... Dua....

VURKUA — Folë bre! mos do dhe një shkrim tjetër për Adhamudhin ?

ZENELI — Jo zot, jo ! jo për Adhamudhin ! po për një tjetër !

VURKUA — Ah ! dolle nga ruga ! e tepërove, e xardillose ! ....

ZENELI — Të lutem, zoti Vurko ! dhe këtë vetëm...

VURKUA — Veç asaj ! a ke tjatër fjalë ?

ZENELI — Të të paguaj.. t'i ndajmë !. .

VURKUA — S'e bëj dot ! s'kam nge ! më presën...

ZENELI — Më ndje !.. këtë herë është për një zonjë ! ...

VURKUA — Për një zonjë ? për cinë bre Zenel ?

ZENELI — Për zonjëzën Lulushe !...

VURKUA — Për mësonjësen e-bukur ! ndëron fjala ! punë që bënet. A erdhi këtu ?

ZENELI — Tani dolli dhe...

VURKUA — A e-pe mirë ? fort e-bukur ?...

BKSH

ZENELI — Mos pyet !

VURKUA — Faqe-kuqe ...

ZENELI — Si një shegë !

VURKUA — Mes hollë ! sy-zezë, gushë-bardhë, ?....

ZENELI — S'ka shoqe...

VURKUA — Ndëgjo, Zenel : kam dy muaj q'i vi rrotull !....

ZENELI — Dhe s'tu-mbarua dot qëllimi ?

VURKUA — Besa jo ! shket si ngjalë.... s'do të ndëgjojë as viershat që kam shkruar për të ! ...

ZENELI — Ahere ç'mendonej?

VURKUA — Ahere të jap fjalën që dotë rri të shkruaj artikullin që kërkon : për kur e-do ?

ZENELI — Sa të munç më ç'pejt, këtë çast ... zoti Vurko, pa ndrim, thuaj s'do gjësent fare për këtë mundrim ? s'do t'i-ndajmë !...

VURKUA — Jo bre vëlla ; mbai për vete... Pastaj kam shpresë se zonjëza Lulushe dotë më paguajë një ditë ndryshe ... (del jashtë duke kënduar:) Lulushe lumi të muar,

në të vënça dot ndë duar !.....

BKSH

IX

ZENELI — VETEM

ZENELI — (vetëm) : Kshtu dua dhe unë... të mos i'ndajmë..... ah ! si-kur të dijë vetë të shkruajë !... Po zonjëza Lulushe s'duket ! (shukon derën): ja vjen përsëri !.... Le të shtirem si-kur kërkoj ! ....

X

ZENELI, LULUSHE

LULUSHE — S'e- ke dhe gjetur ?

ZENELI — Jo dhe ! ... po s'e-hëngri dreqi.... vetëm s'di se ku është futur.

LULUSHE — Dale të të ndih dhe unë....

ZENELI — Jo, jo ! këtu kërkova.... s'ka gjësent. Po më duket se ky shkrim dotë jetë nd'odë t'im Zoti...

LULUSHE — Ah ! ...

ZENELI — Prit këtu sa të vete dhe të vi (del)

BKSH

XI

ZONJA LULUSHE — VETEM

LULUSHE — (vetëm): Të dojë Zoti t'a-gjëjë !...(Merr dhe kqyr dorë-shkrimet ndë tryezë, kur, e-habitur fort thërret): Ah! ç'është kështu sot ! mos më bëjnë sytë ! mos ëndërrit ! Doktor Adhamudhi paska vdekur ! Çudi! Sot ndë mëngjes ish fort mirë, dhe pas fjalës skëndo beut, dotë vinte këtu pas dreke të na tregonte abetarin shqip, me shkronja të ra ! I gjori doktor ! Oh ! s'jemi gjësend kurrë ndë këtë botë ! ... sot jemi, nesër s'jemi... (shikon Adhamudhin që ryn nga dal dhe tmeronet e thotë) : Ah !! lark ! lark !

XII

LULUSHE, ADHAMUDHI

LULUSHE — (me frike) . Lugat ! lugat ! mos m'u-qas ! Mos m'u-qas ! lark ! lark nga unë !....

ADHAMUDHI — (i habitur) : Unë, lugat ! ç'thotë !

LULUSHE — (e-tmeruar : Lugat dhe kuvëndoka !....

ADHAMUDHI — Më ndje zonjë, mbase jam fort i-lik, i-shëmtuar, po lugat nukë jam !....

BKSH

LULUSHE — Qysh !.. s'ke vdekur ?

ADHAMUDHI — Jam m' igjallë se të gjallët...

LULUSHE — Vërtet ?

ADHAMUDHI — Për Zonë ! ...

LULUSHE — Oh ! më ndje : të dijë të vdekur!...

ADHAMUDHI — Pse ? kush të tha ?....

LULUSHE — Këndojë këtë shkrim dhe....

ADHAMUDHI — Cinë shkrim ?

LULUSHE — Besova se thosh të vërtetën.... dhe nga ca fjalë që më kish thënë Zeneli ! ....

ADHAMUDHI — Dale ta sho këtë shkrim !....

LULUSHE — Jo ! Lemë të t'a-këndoj unë, dhe dotë shoç se kush-do që të qe dotë besonte se keshe vdekur vërtet... (këndon shkrimin) Sot msuam se adhamudhi, i-vetë-thënë shëronjës, mbylli të dy sytë ! ... i-ndyeri si-do q'ishte mëndjeshkurtër, ish i-pasur nga e-shoqja, I-ati mukë diet kush ka qënë..... msuam vetëm se ky «sharllatan» ish i-bir'i-të ndyerës Karolinë që vdiq vjet nga uria !... Ky faqe-zi kishte veten për njeri të math dhe mërzinte tërë botën me marrëzitë që thosh posht'e lart. Ish hapur

BKSH

fjalë si-kur kërkonte të helmonte të shoqen që t'i trashëgonte gjënë ! Me të tilla ndjenja ndë zëmër, bëri fort mirë që këputi qafën dhe vdiq nga « dambllaja », natën kur këndoi kokosh i-parë. Mbuloi balta baltën ! »

ADHAMUDHI — (i-egërcuar) : Këto shkruan për mua ?

LULUSHE — Këto ! ...

ADHAMUDHI — (me hidhërim) : ç'njers paska kjo botë !.. unë, mëndje-shkurtër ! ... unë, sharllatan !....

LULUSHE — Çudi, për Zonë ! Çudi e-madhe !...

ADHAMUDHI — Ah ! bëra mirë që këputa qafën ! ah ! mbuloi balta baltën !...

LULUSHE — Nga balta nukë jemi bërë ?

ADHAMUDHI — Vdiqa, thonë, nga dambllа ! Po pse vallë nga dambllа? Kysh e-dinë që nuk dotë vdes nga tërbim, nga plasja?

LULUSHE — Vërtet ! vërtet !. ..

ADHAMUDHI — Unë, njeri i-lik ! Si më di ti mua ?

LULUSHE — Jo ! unë të di për njeri të... mirë !

ADHAMUDHI — Ah ! kjo bot'ësht'e-rrëme: sa rroj më ndero-jnë, kur vdes qënkam i-lik, qënkam për të sharë, për të hedhur ndë baltë ! Ah !... (ryn Zeneli).

BKSH

XIII

ADHAMUDHI, LULUSHE, ZENELI

ADHAMUDHI — Artikullin t'im pse ja dhe zonjës Lulushe ?

ZENELI — Më ndje... e-keshë harruar këtu....

ADHAMUDHI — S'bëre mirë ! Ndëgjo : nga ç'sëmundje, bëson ti, se dotë vdes unë ?

ZENELI — Nuk'e-di, besa '...

ADHAMUDHI — Thuaj bre mëndjen t'ëde kur t'a-kërkojnë !

ZENELI — Unë pandej se dotë këputesh e të biesh nga një shkëmb !...

ADHAMUDHI — Fort mirë... se s'kam për të hipur ndë për shkëmbënj ! Po pse artikulli thotë që sikur vdiqa nga damblla ?

ZENELI — Munt...se ke zverkun të shkurtër ! pastaj më duket se lnatosej tepër....

ADHAMUDHI — Vërtet, vërtet ! ç'jam i-marrë : pse të më vijë kaq'inat për një shkrim që s'është dhe botuar ndë gazetë dhe kurrë nukë dotë botonet, për Zonë se s'kam për të vdekur kurrë, jo ! më martë të keqen artikulli..... (e-çjerr nga inati).

BKSH

ZENELI — Mos kshtu ! mos kshtu ! doktor efendi ! mos mer zjarr, se munt të pësoç nga damblla ! ç'me bëre, zotëni ! pse e çore ? Qysh dot'a vë prapë ndë vënt ? ç'do të thotë im zot ? po punë q'u-bë tani !... mundebare nëmë ç'më ke taksur....

ADHAMUDHI — Ç'do ?

ZENELI — Të dy mexhitet....

ADHAMUDHI — Ah ! dashke të më shajnë dhe të paguaj qënkej i-mënçur !

ZENELI — Ah ! doktor Adhamudhi dalka nga fjala !...

ADHAMUDHI — Jo, bre Zenel, jo ! na, meri mexhitet ! t'i-ap me gjith zëmër.

ZENELI — Dhe un'i-mar me gjithë zëmër, po... mënt për tjatër herë... dotë paguem përpara...

ZONJA LULUSHE — (Zenelit) : A e-mbarove punën t'ime ? a ma gjete shkrimin ?

ZENELI — Tek po e-kërkoj gjegja këtu trazirë dhe arçë me vrap..Poduet të më paguash përpara të pesë mexhitet, ndryshe...

LULUSHE — Dy vetëm, si dhe doktori...

ZENELI — Jo ! gratë gjithënjë paguajnë më tepër....

BKSH

LULUSHE — Ah ! të mjerat gra !...

ZENELI — Po dotë m'i-paguash edhe në qoftë se të shajnë ?

LULUSHE — Mos ki frikë ! le të më shajnë ! si-do që të thonë dotë të paguaj ! (te Adhamudhi): vetëm të dimë se ç'thonë për ne ata që lëme pas !...

ZENELI — A dot'a-çjerç artikullin ?

LULUSHE — Kurrë !

ZENELI — Për shpyrt të mëmës ?

LULUSHE — Për shpyrt të mëmës !

ZENELI — Vete të t'a-bie... (del jashtë).

XIV

ZONJA LULUSHE, ADHAMUDHI

ADHAMUDHI — S't'është mjaft ç'pësova unë ? do dhe ti të provosh ?...

LULUSHE — Oh ! dua ! dua të msoj ç'dotë thonë... Oh ! e-di fort mirë ç'vlejnë lëvdatat për gratë kur janë të gjalla.. Po pas vdekjes e-vërtëta del ndë shesh, mukë fshiet ! ....

BKSH

ADHAMUDHI — E-vërteta !.. Pas mëndjes s'ate duket se këto që shkruajnë per mua janë të vërteta ?

LULUSHE — Më ndje, zotëni! s'ka njeri të pa faj dhe gazetat bëjnë gabime, Po kush e-di ?.. pas një qint vjet. pas dy qint vjet, munt të duket e-vërteta !...

ADHAMUDHI — Pas dy qint vjet ! Po unë, dëshiroj që tani, që sot, të më kupëtojnë se kush jam unë !

LULUSHE — Kur vdes njeriu, nd'atë jetë, një-qint, dy-qint vjet ç'janë ?

XV

ADHAMUDHI, LULUSHE, ZENELI

ZENELI — (i-qaset Lulushes duke thënë) ; Vërtet u-munduash po e-gjeta.

LULUSHE — Të lumtë Zenel ! na, merr mexhitet....

ZENELI — Rrofsh e qofsh e gëzofsh ! s'dalke nga fiala ! (me vetëhe) : Shumë dit'e mbarë sot, si do që bën ftohtë shumë. (me fort): A duani të ndez zjarr nd'oxhak ?

ADHAMUDHI — Pse jo ? (Zeneli ndez zjarrë dhe del jashtë).

BKSH

XVI

ADHAMUDHI, LULUSHE

ADHAMUDHI — Pa të shomë ç'thonë dhe për ty ....

LULUSHE — Dotë shomë, dotë shomë ! Po pse më dridhet dora ? . . .

ADHAMUDHI — Ah ! të vjen frikë ! . . .

LULUSHE — Frikë, jo ! dotë më shoç . . . (rri dhe këndon artikullin) : "Vdekij e zonjëzës Lulushe! . . (i-bie shkrimi nga dora) . Po s' di se ç'kam ! ç'pësova ! . . Më duket si-kur kam vdekur vërtet ! . . .

ADHAMUDHI — (merr artikullin nga sheshi) Dale t'akëndoj unë : «Me hidhërim të math msojmë se zonjëza Lulushe, vdiq pa prit pa pandyer ! Nesër dotë shkruajmë gjer'e gjatë për këtë ëngjëll të dheut, për këtë lule të bukur që nukë la shoqe ndë vënd t'ënë....

LULUSHE — Ah ! ëngjëll ! lul'e-bukur !

ADHAMUDHI — (me inat): Dreq o punë!... të lëvdonet një grua dhe një shëronjës si unë, të shaet !...

LULUSHE — Të lutem zotëni, mos të vijë kaqë rëndë! A u-sos?

BKSH

ADHAMUDHI — (me inat). Jo, jo! nuk'u-sos!...po mere këndoe vetë !

LULUSHE — (mer shkrimin e këndon). «Dora-me-dorë, themi vetëm se e-ndyera Lulushe s'ish vetëm një grua e-bukur, e-mënçur, po një mësonjëse me dituri të madhe, pra të kishte dhe një zëmër të bardhë plot me ndjenja miqësie dhe dashurie të pa anë ! (duke qarë): Vërtet! vërtet! kshtu jam bërë!...(këndon artikullin) : «Prandaj kur u-hap kjo lajm'e zezë ndë qytet, gra e burra, djem e pleq, u-hidhëruan, u-pikëlluan, dhe nukë mbet as një pa vatur t'a-shojë për herën e-fundit, duke derdhur lotë rrëke. Ndë një çast u-mbush shtëpia me njers e me kurorë lulesh dhe ndë mes të këtyre lloi, lloi lulesh të bukura ç'këlqente një kurorë fort e madhe me trëndafil e manushaqe, e zotit Vurkos që s'mbante dot lotë! (dukë garë); Sa bukur dot'ishte!.. Po zoti Vurko ! sa mirë më qënka sjellur !... Dhe unë, kuçedra, se-shojë dot me sy! s'dojë të ndëgjojë as vjershat që shkruante për mua !....

ADHAMUDHI — A u-sos ?

LULUSHE — U-sos!...mirë po s'thotë se nga se vallë vdiqa!...

ADHAMUDHI — Ah ! ty të lënë të vdeç si të duash ! Vetëm për mua, dua s'dua, damblla !... Na, se ç'do me thënë të jesh grua e bukur ! të lëvdojnë, të sjellin lule, të ngrënë ndë Qiell !

LULUSHE — S'pandejë kurrë, s'besojë të keshë të tërë katundarët miq !...

ADHAMUDHI — Unë vetëm i paskam armiq të tërë ! ti qënkej fatmiroshe ! ...

LULUSHE — Zotëni, mos pande se kur jesh'e gjallë s'kam vuar ndë jetë t'ime.

ADHAMUDHI — Mirë po tani ?...

LULUSHE — Ç'fitim kam? kur vdes njeriu s'kupëton gjë-send...

ADHAMUDHI — Oh ! mos ki keq se s'ke dhe vdekur vërtet

LULUSHE — Ah ! po as zotrote s'ke dhe vdekur !

ADHAMUDHI — Unë ! si-kur të mos dojë të rrojë dotë vrasë vetëhenë !..

LULUSHE — Qysh ? Për një shkrim të keq ?...

ADHAMUDHI — Jo, jo ! s'dua të vdes, pa marrë gjaknë ! Shuko : kjo është m'e-bukura veprë që kam shkruar ndë jetë t'ime ! Eshtë Abetari shqip ! abetar i-ri ! vetëm me këtë abetar mund të përparojë shqipja ! ndryshe nukë shkruet !

LULUSHE — Qysh? neve sot e shkuajmë me shkronja Llatinçe fort bukur !..

BKSH

ADHAMUDHI — Gjipura ! zëmëronen Musulmanët ! Po as shkronja Arabishte që dëshëronte Haxhi Alin, nukë bëjnë se zëmëronen të krishtërët !

LULUSHE — Ahere ?....

ADHAMUDHI — Ahere u menduash ç'duet bërë që të kënaqen të dy palët ?

LULUSHE — Ç'duet bërë ?

ADHAMUDHI — Të përdorim shkronja llatinçe që të kënaqen të Krishtërët....

LULUSHE — Fort mirë !

ADHAMUDHI — Po të mësojmë të shkruajmë si Arabët, nga e djathta më të mëngjër, që të kënaqen Shqipëtaret Muslymanë :

LULUSHE — Ah !.. Po si munt të shkruajmë ?....

ADHAMUDHI — Eh ! ... prandaj shkrova këtabetar ! për këtë qëllim ! ... Po nuk'e botoj ! Dreqi t'i marë Shqipëtarët dhe Shqipen !... S'e botoj, jo ! kur s'ma dinë kur më shajnë ! dotë mar gjak !..Dot'a djeg abetarin ! (e-heth ndë zjar).

LULUSHE — Mos zotëni, mos e bën këtë të keqe !

ADHAMUDHI — Jo, jo ! Le të digjet !..Shqipëtarët kur qënkan të tillë, le të vuajnë nd'erësirë! Nukë dot'a shonë abetarin, t'im,

BKSH

kurrë, kurrë !

XVII

ZENELI, ADHAMUDHI

ZENELI — (te Adhamudhi) : Ç'punon kshtu ? Dotë na djegsh shtëpinë !...

ADHAMUDHI — U djegtë gjithë Shqipëria !...

ZENELI — Pastaj ç'dotë bëjnë Xhon-Turkit? (te zonja Lulshe): Ku m'a ke artikullin ?

LULUSHE — Mere, Zenel, mere! (ja ep).

ZENELI — Të lumtë ! Tani vete t'a shpie prapë ndë vënd (te Adhamudhi) : Ndëgjo: im zot më tha me telefon të të them me gojë se nukë ka nge sot të vijë këtu të shojë abetarin shqip !

ADHAMUDHI — (me rrëmbim) : Nukë dot'a shojë as sot, as mot, as kurrë ! (ikën i zëmëruar dhe pas del edhe Zeneli jasht dhë ryn zoti Vurko).

XVIII

ZONJEZA LULUSHE, VURKUA

VURKUA — (shtiret sikur s'ekish parë Lulushen) Ah ! zonjëza Lulushe këtu !...

BKSH

LULUSHE — Ah ! zoti Vurko ! T'u ngjatë, zoti Vurko.

VURKUA — T'u rritë...zonjëzë ! Qysh këtu ?

LULUSHE — Po dhe zotrote, nga dolle ?

VURKUA — Erdha të sho Skëndon.

LULUSHE — Sa gëzonem që të sho mir'e shëndosh ! Mendoneshe ku të të gjëjë që të ngjatjetojë për ..

VURKUA — Përse, zonjëzë ?

LULUSHE — Po për kurorën me lule të bukura që më solle ditën që vdiqa !...

VURKUA — Ditën që vdiqe ?

LULUSHE — Ah ! vertet !...zotrote nukë mund të kupëtosh..... nukë pe se ç'gjau... Po ndëgjo, zotëni : Sot e tutje jam mikja jote ! Oh ! mike me të vërtetë ! mike për kokë !...mike me mish e me shpyrt !... Dhe të viç kurdo që të duash të më gjëç ndë shtëpi t'ime, pa ndrim, dhe të më këndoç vjershat e bukura që ke bërë për mua ! (Qaset e i ep dorën, të cilën Vurkua e mer e puth me gas të math).

FUND

BKSH

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
BIBLIOTEKA KOMBËTARE
TIRANË

BKSH

BKSH

BKSH